

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	<b>Fakulteti i Arkitektures, Dizajnit dhe Teknologjisë së Drurit</b>
<b>Programi:</b>	<b>Dizajni dhe Konstruksionet e Produkteve nga Druri</b>
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>Praktikë</b>
<b>Niveli:</b>	<b>Bachelor</b>
<b>Statusi lëndës:</b>	<b>Obligative</b>
<b>Viti i studimeve:</b>	<b>III</b>
<b>Numri i orëve në javë:</b>	<b>4</b>
<b>Vlera në kredi - ECTS:</b>	<b>6</b>
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	<b>Ligj. MSc. Bujar Jashari</b>
<b>Detajet kontaktuese:</b>	<b>bujar.jashari@ushaf.net</b>
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	
	<p>Lënda e praktikës profesionale i ofron studentit njohuri të përgjithshme mbi mënyrën e punimit të një produkti të gatshëm nga fillimi e deri në fund të ciklit të prodhimit.</p> <p>Lënda ngërthenë në vete komponentën e njohurive të studentëve që i kanë mësuar gjatë viteve të studimit, të cilat kanë të bëjnë me dizajnin dhe arkitekturën e Interierit, projektimin e produkteve të drurit, përgatitjen e projekteve me anë të softuerit, e deri në implementimin e projektit të tyre të përgatitur në grupe.</p>
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	
	<p>Qëllimi i kësaj lënde është të pajisë studentët me njohuritë dhe mënyrën e përgatitjes së projektit për ekzekutimin e tij në Praktikë. Gjithashtu ka për qëllim të pajisë studentin me njohuritë e punës praktike që ofrohet nga ndërmarrjet dhe nga puna laboratorike e studentit në Laborator.</p>
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	
	<p>Pas përfundimit të këtij moduli, studentët do të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Bëjnë dizajnin e një produkti,</li> <li>• Të caktojnë prerjet e nevojshme të cilat duhet ti bëhen produktit,</li> <li>• Të përgatisë produktin në praktikë (në rast të pamundësisë së produktit të gatshëm, të përgatitet në maketë).</li> <li>• Të bëj skemën e montimit të produktit,</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të llogarisë koston e produktit.</li> </ul>		
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit</b> <b>(gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	4	2	8
Ushtrime teorike/laboratorike	4	1	4
Punë praktike	4	12	48
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	10	10
Ushtrime në teren			
Kollokfiime,seminare	4	10	40
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	10	30
Përgaditja përfundimtare për provim	2	2	4
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)			
Projektet, prezentimet ,etj	2	3	6
<b>Totali</b>			<b>150</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Ligjerata dhe ushtrime të kombinuara me raste të studimit në klasë dhe në terren (fabrika)		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	Provimi final i vlerësuar me 100% të notës. Provimi përbëhet prej projektit të studentit.		
<b>Literatura</b>			
<b>Literatura bazë:</b>	Literaturë të ndryshme të cilat janë në funksion të punimit të projektit.		
<b>Literatura shtesë:</b>			
<b>Plani i dizajnuar i mësimi:</b>			
<b>Java</b>	<b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>		
<i>Java e parë:</i>	Njohja me lëndën "Praktikë"		
<i>Java e dytë:</i>	Ushtrime: Vizatimi i produktit, Paraqitja e tij në projeksionet e nevojshme, Caktimi i prerjeve të nevojshme		
<i>Java e tretë:</i>	Ushtrime: Zhvillimi i një projekti (shembull në klasë)		

<i>Java e katërt:</i>	Caktimi i Produktit për seminar (në fabrikë)
<i>Java e pestë:</i>	Vizatimi dhe paraqitja në projeksione e produktit
<i>Java e gjashtë:</i>	Nxjerrja e detaleve të nevojshme
<i>Java e shtatë:</i>	Përgatitja e skemave të prerjes
<i>Java e tetë:</i>	Llogaritja e shfrytëzimit materialit.
<i>Java e nëntë:</i>	Makinat e nevojshme për realizimin e produktit
<i>Java e dhjetë:</i>	Llogaritja e kostos së materialit
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Konsultime në klasë
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Finalizimi i produktit në letër
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Finalizimi i produktit në praktikë ose maketë
<i>Java e katërmëdhjetë:</i>	Prezantimi i produktit grupi I
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Prezantimi i produktit grupi II
<b>Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</b>	
<i>Vijueshmëria e rregullt, mbajtja e qetësisë dhe angazhimi aktiv në dialog gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve është e obligueshme.</i>	